



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 152, datë 25.11.2021

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Raportit me nr. 2145/57 prot., datë 19.11.2021 dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese në Aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 05.03.2021, “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr.458, rruga “Bajram Tusha”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.
2. Miratimin e shtesës së subjektit përfitues në Aneksin nr.1 “Pallati nr.458, rruga “Bajram Tusha”, Zona Kadastrale 8516”, sipas tabelës si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET</b>
21	IDRIZ GLLOGA	4	2+1

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 26.11.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. ~~94~~ / prot.  
3

Durrës, më 10.12.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës



13.12.21 12467/11

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.152 datë 25.11.2021 “Për miratimin e një shtese në Aneksin 1, të VKB Nr 28 dt 05.03.2021 “ Për miratimin e listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 458 Rr. Bajram Tusha, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, i ndryshuar”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

